Njoftim për përqendrim me të cilin ENNA SOLAR d.o.o., Kroaci, do të fitojë kontrollin mbi CIC GREEN ENERGY MEDGIDIA S.R.L., Rumani

(Lënda nr. 08-151/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 20.10.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftimi për përqendrim, me të cilin ENNA SOLAR d.o.o., me seli të regjistruar në zonën ekonomike Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, do të fitojë kontrollin mbi CIC GREEN ENERGY MEDGIDIA S.R.L., me seli të regjistruar në komunën Valu lui Traian, rruga Calea Dobrogei nr. 131, parcela 1/1, qarku Konstanca, Rumani.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste

ENNA SOLAR d.o.o. është shoqëri që merret me zhvillimin dhe investimin në projekte dhe kapacitete për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, duke përfshirë centralet diellore dhe ato me erë, si dhe sistemet e ruajtjes së energjisë elektrike në bateri (BESS), në Kroaci dhe më gjerë në Evropë. ENNA SOLAR d.o.o. është pjesë e Grupit ENNA, një investitor kryesor në transformimin e gjelbër në rajon.

ENNA SOLAR d.o.o. është pjesë e Grupit ENNA. ENNA është një investitor kryesor dhe një nga grupet e investimeve me rritjen më të shpejtë në Kroaci përkushtuar për të mundësuar zgjidhje inovative që nxisin transformimin e gjelbër dhe krijojnë vlerë afatgjatë për partnerët dhe komunitetin, si në sektorin e energjetikës, ashtu edhe në sektorin e transportit, përkatësisht të logjistikës.

ENNA SOLAR d.o.o. është në pronësi 100% të shoqërisë ENERGIJA NATURALIS d.o.o. për investime dhe menaxhim (ENERGIJA NATURALIS d.o.o. za ulaganje i upravljanje), e cila është në pronësi të shoqërisë SUSTAINABLE SOLUTIONS HOLDING AG, pronar i së cilës është personi fizik P.V.

P.V. është gjithashtu pronari përfundimtar i Grupit FORTENOVA, i cili është i pranishëm në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime MERCATOR MAKEDONIJA shpknjp Shkup – në likuidim, me NUAS 5938848 dhe me seli në rrugën Ognjan Prica nr. 1/3-28, mezani, Shkup – Kisella Vodë. Veprimtaria e saj kryesore e regjistruar është tregtia me pakicë në dyqane të paspecializuara, kryesisht me produkte ushqimore, pije dhe duhan. Shoqëria në fjalë nuk ushtron veprimtari tregtare dhe është në procedurë likuidimi.

Grupi P.V. (Grupi ENNA dhe Grupi FORTENOVA) realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga shitja e produkteve ushqimore, si vajra ushqimorë, margarinë, majonezë, ujëra minerale dhe lëngje, salca dhe shurupe, si dhe produkte të mishit të përpunuar.

CIC GREEN ENERGY MEDGIDIA S.R.L. është shoqëri që zhvillon dhe zotëron një sistem fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike me teknologji diellore fotovoltaike, si dhe një sistem për ruajtjen e energjisë elektrike në bateri (BESS), të vendosur në Medgidia, Rumani.

CIC GREEN ENERGY MEDGIDIA S.R.L. nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në territorin e saj.

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit, parashtruesi propozon që tregu përkatës i produkteve të përkufizohet si tregu i zhvillimit të projekteve të infrastrukturës energjetike, duke përfshirë sistemet e ruajtjes së energjisë elektrike në bateri dhe projektet për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi..

21.10.2026
Shkup